



AVOKATI I POPULLIT



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**NJOFTIM**

**PËR**

**SHPALLJEN E REKRUTIMIT PËR 1 (NJË) SPECIALIST ME  
KONTRATË TË PJESSHME PUNE**

Në kuadër të zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon të rekrutojë me kontratë të pjesshme pune (6 ore ne dite):

- 1 (një) Specialist për fushën e “Protokoll/ Arkivë”

**Përshkrimi i punës i specialistin në fushën e “Protokoll – Arkivë”**

Mbështetja për sektorin e protokollit dhe arkivës fokusohet në çështje që lidhen me:

- ✓ Marrjen në dorëzim dhe shpërndarjen e postës, evidentimin dhe protokollimin e saj në regjistrat përkatës
- ✓ Mbajtjen dhe administrimin e librave e dorëzimit të shkresave të korrespondencës brenda institucionit të Avokatit të Popullit
- ✓ Përcjelljen e shkresave të ndryshme tek strukturat përkatëse të institucionit
- ✓ Mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe kujdesi për sigurimin e kushteve për organizimin dhe mirëadministrimin e dokumentacionit që ndodhet në Zyrën e Protokollit
- ✓ Shpërndarjen e dosjeve të punuara nga ekspertët në Seksionet përkatëse
- ✓ Përpunimin e dokumentave të arshivuara në arkivën e Institucionit si dhe menaxhimin e fondit arkivor
- ✓ Ndjekjen e çdo detyre tjetër të ngarkuar nga eprorët

## **Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidateve**

### **A. Për specialistin në fushën e “Protokoll – Arkivë”**

Kandidatët që duan të aplikojnë për këtë pozicion, duhet të plotësojnë kriteret dhe procedurat e mëposhtme:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë
- Të ketë të paktën 1 vit ekperience pune
- Të ketë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi;
- Të ketë fleksibilitet, aftësi të forta adaptimi dhe aftësi për punë në ekip
- Të ketë njohuri të mira kompjuterike

### **Orari dhe Periudha**

Kandidatët fitues do të rekrutohen mbi bazën e një kontrate pune me kohë të pjesshme (6 orë në ditë), për një periudhë kohore 10 (dhjetë) mujore.

Orari ditor i punës do të jetë nga ora 9.00 – 15.00 me fleksibilitetin që në raste urgjente dhe të domosdoshme puna të vijojë edhe përtej fashës së orarit të punës të përcaktuar më sipër

### **Procedurat e Përgjithshme të Aplikimit:**

Aplikimi duhet të përmbajë:

- Letër motivimi
- Curriculum Vitae (CV)
- Kopje e diplomës
- Çertifikatë, dëshmi
- Kopje e librezës së punës
- Dëshmi të gjuhës së huaj (nëse ka)
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore

Aplikimet duhet të dërgohen në rrugë elektronike në adresën:

[burimenjerezore@avokatipopullit.gov.al](mailto:burimenjerezore@avokatipopullit.gov.al): ose në zarf të mbyllur duke specifikuar pozicionin në adresën:

**Institucioni i Avokatit të Popullit**  
**Blv. "Zhan D'Ark", nr 2, Tiranë**  
**Shqipëri**

Në vëmendje të Sektorit të Burimeve njerëzore

### **Afati**

Aplikimet pranohen deri në datë 06/ 03/ 2023, ora 16.30. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumenteve vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë.